

VENDIM
Nr. 125, datë 27.2.2026

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 115, DATË 5.3.2014,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS
DISIPLINORE DHE TË RREGULLAVE PËR KRIJIMIN, PËRBËRJEN E
VENDIMMARRJEN NË KOMISIONIN DISIPLINOR NË SHËRBIMIN CIVIL”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 10, të nenit 59, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 115, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) Në kreun I bëhen këto shtesa:

i. Në fund të shkronjës “d”, të pikës 2, shtohen fjalët “... ose zëvendëssekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, për procedurën disiplinore të nisur, sipas shkronjës “b”, të pikës 6/1, të kreut II, të këtij vendimi.”;

ii. Në fund të shkronjës “d”, të pikës 3, shtohen fjalët “... ose zëvendëssekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, për procedurën disiplinore të nisur, sipas shkronjës “b”, të pikës 6/1, të kreut II, të këtij vendimi.”.

b) Pika 6/1, e kreut II, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6/1. Përgjithimisht, kërkesa/rekomandimi i depozituar në institucion, sipas pikës 3, të këtij kreu, i dërgohet komisionit disiplinor për rastet kur:

a) shkeljet disiplinore të pretenduara janë konstatuar nga Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje;

b) shkeljet disiplinore të pretenduara janë konstatuar gjatë veprimtarisë së grupit akselerator nga zëvendëssekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave.”.

2. Ngarkohen institucionet, pjesë e fushës së veprimit të legjislacionit për nëpunësin civil, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama